

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-5100-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Analiza gjeoteknike ,sizmike dhe hidrologjike per projektin SOLAR 4KOSOVA – I FOTOVOLTAIK 100MW.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Lorenzo & CO.
NUI	J61903071B
Adresa	Rr. Dritan Hoxha
Vendi	Tirane
Kodi postar	1001
Numri Telefonit	+38349235424
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lorenc Zani
Adresa elektronike	office.lorenco@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	14.08.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Analiza gjeoteknike ,sizmike dhe hidrologjike per projektin SOLAR 4KOSOVA – I FOTOVOLTAIK 100MW.

Shkelja e :

Neni 7 i LPP : Barazia dhe trajtimi /Jo Diskriminimi

Neni 59 i LPP:Ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Pergjigja e AK date 04.08.2023 e cila nuk merr parasysh KERKESEN PER RISHQYRTIM

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP : Barazia dhe trajtimi /Jo Diskriminimi

Neni 59 i LPP:Ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 31.07.2023 përmes platformës së Prokurimit kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK.

Ne këtë Njoftim ne si OE kemi pranuar dy letra Standarde !

Në Letrën e parë, kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK duke shpallur fitues OE IMK BALLKAN PROJEKT Shpk

Në letrën e dytë standarde Njoftim për tenderuesin e eliminuar ku jepet arsyeja e eliminimit si më poshtë:

“Ju nuk keni ofruar Referenca të jenë për punë të ngjashme me fushëveprim të ngjajshëm të punëve në projekte solare ose të erës.”

Mendojmë që eliminimi ynë për arsyen e mësipërme është i padrejtë për arsyet si më poshtë:

Referenca jonë është me digat të cilat kanë fushëveprim të ngjajshëm me projekte solare ose të erës sepse prej tyre mund të prodhohet energji elektrike njëloj si nga projektet solare apo të erës.

Projektet e digave janë shumë herë me komplekse se ato të erës dhe më tepër akoma se edhe ato solare sepse peshat që ato mbajnë janë shumë herë më të mëdha dhe nuk ndikohen vetëm nga pesha apo nga era por edhe nga faktorë të tjerë më komplekse.

Studimet gjeologjike, sizmike dhe ato hidrologjike për nga natyra janë të njëjta në qdo vepër ndërtimore qofshin këto diga, ura, panele solarë, turbina të erës apo objekte banesorë dhe fakti që janë punë të ngjashme për projekte solare ose të erës apo jo nuk përbën asnjë ndryshim thelbësor.

Pretendimi juaj në këtë Letër standarde nëse punët e ngjashme i përmbajnë fjalët “solar” ose “erë” nuk qëndrojnë pasi që ne jemi OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë të ofertuar.

Kërkojmë nga AK që të bëjë rivlerësimin e tenderit dhe ne te shpallemi fitues pasi që jemi OE që i plotësojmë kishtet dhe me çmim më të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*